



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 17.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës 14.10.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **N.T.SH MEDICOM** lidhur me **Lot-in: 3** të aktivitetit të prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë”** me Nr. të Prok: 206-24-8799-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **N.T.SH MEDICOM**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë”** Lot 3 me nr. prokurimi 206-24-8799-1-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 09.10.2024 të publikuar në platformën elektronike.
- II. Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 09.10.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **N.T.SH MEDICOM**, me datën 14.10.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë”** Lot 3 me nr. prokurimi 206-24-8799-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datën 17.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues N.T.SH MEDICOM:

Neni 59, paragrafi 4 i LPP-së;

Neni 60, paragrafi 1, nenparagrafi 1.1 i LPP-së;

Neni 1, paragrafi 1 i LPP-së;

Pretendimi ankimore te OE ankues N.T.SH MEDICOM:

MS Medicom, ka ofertuar në kuadër të LOT 3 me prodhuesin dhe liderin global Fresenius Medical Care, i cili shërben rreth 35-45% të tregut të Bashkimit Evropian (BE), dhe është lider në të gjitha globin për pajisje dhe shërbime të tilla. Autoriteti Kontraktues, duke vepruar në shkelje të parimeve bazë të Ligjit të Prokurimit, ka eliminuar kompaninë më serioze në kuadër të Bashkimit Evropian, dhe gjithashtu ka rekomnduar për Kontratë kompaninë tjetër (e trajtuar si sekrete) e cila ka ofertuar me rreth 60 mijë Euro më shtrejtë.

Në arsyetimin për eliminim, Autoriteti Kontraktues arsyetohet se eliminimi është për shkak se OE Medicom ka ofertuar me cmime zero. Kjo nuk është e saktë për shkak se:

1. MS Medicom ka ofertuar në LOT 3 me cmime të tregut dhe nuk ka ofruar me cmime zero (0);
2. MS Medicom, si distributor i kompanisë lidere evropiane Fresenius Medical Care Gjermani, ka qenë i detyruar të ofertojë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe e ka pasur të ndaluar të faturojë Ministrinë e Shëndetësisë për shërbimet e instalimit të pajisjeve të shitura të reja të përfshira në cmim në kuadër të LOT 3 (pjesa 1, 2 dhe 3);
3. MS Medicom e ka pasur ligjërisht të ndaluar të faturojë dyfish Autoritetin kontraktues, kjo pasi ky do ishte abuzim me legjislacionin e Kosovës dhe të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e konkurrencës. Për më tepër, kjo ka qenë Kontratë Furnizimi, dhe jo shërbimeve.

1. Baza Faktike

Me datën 23 shtator 2024, OE N.T.SH. "M.S. MEDICOM" dorëzon tenderin e tij, ku për Lot-3, oferton në shumën prej EUR 288,365.00. Përkundër se i plotëson të gjitha kërkesat e e Dosjes së Tenderit, dhe ka pasur ofertën më të lirë.

Me datën 02 tetor 2024, AK përmes Letër Standarde të Kërkesës për Sqarimin e Tenderit kërkon sqarime nga OE N.T.SH. "M.S. MEDICOM" se pse për pikën 4 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme të Dosjes së Tenderit, për Lot-3, ofertohej çmimi prej EUR 0.00.

Me datën 07 tetor 2024, OE N.T.SH. "M.S. MEDICOM" jep sqarime se oferta e tij në pikën 4 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme për Lot-3 është e përshtatshme dhe e përgjegjshme për shkak se:

- a. MS Medicom ka ofertuar në LOT 3 me cmime të tregut dhe nuk ka ofruar me cmime zero (0);
- b. MS Medicom obligohet nga e drejta e Bashkimit Evropian që të mos faturojë Ministrinë e Shëndetësisë për shërbimet e instalimit të pajisjeve të shitura të reja të përfshira në çmimin në kuadër të LOT 3.

Me datën 09 tetor 2024, AK përmes Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, njofton OE N.T.SH. "M.S. MEDICOM" se oferta është refuzuar si e papërgjegjshme mbi bazën e nenit 40, paragrafit 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

OE N.T.SH. "M.S. MEDICOM" ka plotësuar të gjitha kushtet nga Dosja e Tenderit. Pra AK ka shkelur nenin 59, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 05/L-068, duke shpallur OE N.T.SH. "M.S. MEDICOM" si të papërgjegjshëm. Ndërsa, neni 60, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i Ligjit Nr. 05/L-068 është shkelur pasi që OE N.T.SH. "M.S. MEDICOM" ka ofertuar çmimin më të lirë në ofertën e tij.

Përveç kësaj, oferta e OE N.T.SH. "M.S. MEDICOM" nuk mundet të konsiderohet dhuratë ashtu që të refuzohet mbi bazën e nenit 40, paragrafit 16, pikës b të Rregullores së Prokurimit Publik.

Prentimi Ankimor I - MS Medicom ka ofertuar në LOT 3 me cmime të tregut dhe nuk ka ofruar me cmime zero (0) dhe ka ofertuar sipas obligimeve nga e drejta e Bashkimit Evropian që të mos faturojë dyfish Autoritetin kontraktues

Pretendimi nr. 1 - Oferta për pikën 4 të Specifikimit Teknik të Dosjes së Tenderit për Lot-3 nuk është dhuratë Sipas nenit 40, paragrafit 1.6. të pikës b të Rregullores së Prokurimit Publik, AK do të refuzoj një tender nëse thotë se ky artikull është ofertuar falas - pra me çmimin EUR 0.00, për shkak se dhuratat nuk janë të pranueshme. Megjithatë, kjo ndalesë nuk aplikohet në rastin e ofertës së MS Medicom dhe ofertës së dhënë për LOT 3. Kjo për dy arsye të ndara.

Arsyeja e parë është me faktin se interpretimi i KRPPP aplikohet vetëm në rastet kur i tërë LOT ofrohet falas dhe me çmim zero. Vetëm në atë rast, sipas interpretimit të KRPP-së, oferta duhet të refuzohet për shkak të çmimit zero. Në rastin tonë, oferta e MS Medicom për LOT 3 është ofertë me çmim të tregut, në shumën prej EUR 288,365.00. Rrjedhimisht, oferta e LOT në asnjë rrethanë nuk mund të klasifikohet si ofertë me çmim zero.

Duke aplikuar edhe një hap tutje, arsyeja se pse ndalohet ofertimi me çmime zero (0) ka të bëjë me legjislacionin e aplikueshëm për mbrojtjen e konkurrencës. Kjo për arsye se duke mos pasur arsye ekonomike për ofertimin me çmime zero (0), e vetmja arsye se pse një operatorë mund të ofertojë me çmime të tilla është për të prishur konkurrencën dhe për të fituar avantazh në raport me konkurrentët tjerë (ngjashëm me idenë e çmimeve abnormalisht të ulëta, apo tejkalimin e buxhetit).

Përveç kësaj, në rastin konkret, oferta për pikën 4 të Specifikimeve Teknike, e që është vetëm instalim i artikujve të ofruar, nuk mundet të konsiderohet dhuratë pasi që ky pozicion vjen së bashku me artikujt e ofruar për pikën 1, 2 dhe 3 të Specifikimeve, dhe legjislacioni i BE-së i ndalon OE që të faturojë AK me kosto të dyfishtë për pajisje të reja.

MS Medicom është distributor i kompanisë lidere evropiane Fresenius Medical Care Gjermani, kështu duke i'u nënshtruar rregullativës ligjore të Bashkimit Evropian lidhur me mbrojtjen e Konkurrencës. Kjo rrethanë afekton drejtëpërdrejtë faturimin nga MS Medicom për Ministrinë e Shëndetësisë, duke e ndaluar MS Medicom të faturojë për pajisjet e shitura të përfshira në çmimin në kuadër të LOT 3. Kjo pasi çmimi i pajisjeve (sipas nën-pikës 1, 2 dhe 3, përfshinë edhe instalimin).

Fillimisht, sipas Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), nenit 101 (Marrëveshjet kundër konkurrencës), ndalohen ato marrëveshje, vendime ose praktika të bashkërenduara ndërmjet kompanive që kufizojnë konkurrencën, si kartelet e fiksimit të çmimeve ose të ndarjes së tregut. Në lidhje me këtë, neni 102 i TFEU (Shpërdorimi i Pozitës Dominuese), ndalon shoqëritë me pozitë dominuese në treg të keqpërdorin pozicionin e tyre për të përjashtuar konkurrentët ose për të shfrytëzuar konsumatorët. Në mënyrë të drejtëpërdrejtë, kjo ndalon edhe faturimin e dyfishtë, apo kufizimin e shitjes së një pajisje me kosto shtesë për konsumatorët për instalimin dhe vendosjen në punë të pajisjeve të tilla.

Ndërsa, nenet 107-109 (Ndihma Shtetërore), përcaktojnë se kontrolli mbi subvencionet e qeverisë për kompanitë bëhet për të siguruar që ato të mos shtrembërojnë konkurrencën duke dhënë avantazhe të padrejta. Kjo ndalon pagesat e dyfishta.

Përveç kësaj, Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1/2003 zbaton rregullat e përcaktuara në nenet 101 dhe 102 të TFBE dhe fuqizon Komisionin Evropian dhe autoritetet kombëtare për të zbatuar ligjin e BE-së për konkurrencën. Rregullorja përcakton procedurat për hetimin dhe penalizimin e kompanive të përfshira në praktika antikonkurrese.

Kjo e bën MS Medicom direkt përgjegjës pranë autoriteteve të BE-së në rast të shkeljeve.

Rrjedhimisht, në përputhje me legjislacionin e BE-së, MS Medicom e ka pasur të ndaluar të faturojë me kosto të dyfishtë Ministrinë e Shëndetësisë për pajisje të reja.

Përfundimisht, kjo procedurë e prokurimit ka qenë Kontratë Furnizimi, dhe si e tillë nuk mund të eliminohet një ofertë sa i përket shërbimeve të përfshira aty.

Pretendimi nr. 2 - Autoriteti Kontraktues ka vepruar kundërligjshëm duke mos lejuar qasje as në emrin e prodhuesit dhe pajisjet e ofertuara të operatorit të rekomanduar për Kontratë.

Ka dyshime që oferta e të rekomanduarit për Kontratë është e papërgjegjshme. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues duke vepruar kundërligjshëm refuzon të jepë qasje në pajisjet e ofertuara dhe ofertën e palës së rekomanduar.

Bazuar në kërkesën e të rekomanduarit për Kontratë, Autoriteti kontraktues ka klasifikuar të gjitha informacionet e ofertës së këtij OE si Informacione Sekrete Afariste.

Dokumentet në lidhje me përgjegjshmërinë e Operatorëve Ekonomik, kjo lidhur me Nenin 59 për Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, nuk mund të klasifikohen asnjëherë si Informacione Sekrete Afariste. Kjo pasi që një klasifikim i tillë do e bënte tërësisht të pakuptimtë tërë legjislacionin e prokurimit publik dhe parimin e transparencës.

Një Kërkesë për Informacion Sekret Afarist në asnjë rrethanë nuk lejohet të përfshijë tërë dokumentet tenderuese, por Kërkesa duhet të jetë në lidhje me një dokument specifik dhe në lidhje me të dhëna specifike të cilat mbrohen. Kërkesat gjenerale duhet të refuzohen në mënyrë automatike nga AK.

Fakti se OE ka paraqitur Kërkesë për të klasifikuar një dokument të tenderit si Sekret Afarist, nuk e bënë informacionin sekret. Lidhur me Kërkesën, AK duhet të vendosë me Vendim të veçantë me shkrim, nëse e njëjta - Kërkesa - i plotëson kushtet ligjore për t'u trajtuar si informacion sekret, të cilat rrjedhin nga Neni 11, paragrafi 3, i LPP-së.

Kushtet që një informacion të trajtohet si Sekret Afarist janë të detajuara dhe, ndër të tjera, duhet të ketë arsyetim të detajuar si dhe prova se publikimi i një informacioni të tillë shkakton dëm.

Në rast se AK vendosë që një dokument i caktuar, specifikisht i identifikuar, përmban Informacion Sekret Afarist, atëherë, në bazë të paragrafit 4 të Nenit 11 të LPP-së, duhet të përgatisë versionin e "pastruar" të atij dokumenti. Kjo duke e pastruar vetëm Informacionin Sekret Afarist dhe duke e lënë tërë dokumentin tjetër për inspektim. Neni 11, paragrafi 4, i LPP-së, përcakton që:

“Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3.”

Andaj, në rast se AK ka marrë Vendim që ndonjë dokument të dosjes së kërkuara ta cilësojë si sekret, OE Ankues kërkon nga i njëjti që të tregojë specifikisht se cilat dokumente AK i ka pranuar si sekrete dhe t’ia dërgojë versionin e pastruar të të njëjtave. Në të kundërtën, AK do të shkelte Nenet 10, 11 dhe 59 të LPP-së.

Megjithatë, si palë me interes, OE Medicom ka të drejtë të njoftohet se me çfarë pajisje dhe me çfarë prodhuesi ka ofertuar i rekomanduari për Kontratë.

2. Perfundimi dhe kërkesa

4.1. Mbi bazën e argumenteve të mësipërme, ftohet Autoriteti Kontraktues që të nxjerr Vendim ashtu që:

- I. Aprovohet N.T.SH. “M.S. MEDICOM” për rishqyrtim si e bazuar; ashtu që
- II. Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënie të Kontratës për Pjesën/Lot 3 të Aktivitetit të Prokurimit 206-24-8799-1-1-1
- III. Njoftohet N.T.SH. “M.S. MEDICOM” për dhënie të Kontratës së Prokurimit.

Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin ankimorë te OE ankues:

Në lidhje me pretendimin e juaj rreth eliminimit tuaj, ne si AK-MSh nuk pajtohemi me kete pretendim, duke marre parasysh se ju keni ofertuar me pershkrimin e çmimeve duke e plotesuar artikullin nr. 4 me çmim 0.00, si me poshtë:

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE - LOT 3

Furnizimet me Pajisje Mjekësore dhe Inventarit Medicinal për Poliklinikën në Podujevë							
Nr. Art	PËRSHKRIMI I PAJISJEVE	Njësia	Sasia/Copë	Çmimi njësi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1	Aparate për Dializë - HD me të gjitha kyqjet që nevojiten për tu funksionalizuar hapësira për përdorimin e pajisjeve.	Copë	16	8,314.81	665.19	8,980.00	143,680.00
2	Shtretër të HD me tavolinë (set) komplet.	Copë	15	3,476.85	278.15	3,755.00	56,325.00
3	Furnizim me Osmozë Reverze - komplet, kërkohet t’i përmbushë kriteret e prodhimit të ujit të pastër, absolutisht të dejonizuar për dializë. Kapaciteti i Reverzë Osmozës duhet të jetë minimum për 15 aparate të Dializës.	Copë	1	74,881.36	13,478.64	88,360.00	88,360.00
4	Të bëhet instalimi i të gjithave elementeve që duhet për vendosjen e aparaturave të Hemodializës në dhomën HCV- Hepatitis C virus dhe dhomën me Hepatit B Virus.	Copë	1	0.00	0.00	0.00	0.00
TOTALI i përgjithshëm për Lot 3 (DDP):							€ 288,365.00

Artikulli 4 te Përshkrimi i Çmimeve ka qene i ndare nga tre pozicionet paraprake, dhe ju keni ofertuar me 0.00, e cila bie ndesh me nenin 40.16 të Rregullores Nr. 001-2022 për prokurimin publik, ne te cilen specifikohet qarte **Në rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull/pozicion të veçantë**

40.16 Në rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull/pozicion të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet që të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro.

- a. Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet.
- b. Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.

Artikulli 4 ka pershkrim te sherbimit qe kerkohet te kryhet, ka njesi matese (copë), ka sasi matese (1), andaj si i tille eshte dasht te plotesohet me vleren e instalimeve te kerkuara, meqense ne kerkesen e AK ky pozicion ka vlere te parashikuar prej 5,000.00 euro dhe dy OE konkurent per kete Lot 3 e kane plotesuar me vlerat 5,000 respektivisht 12,000 euro.

Si AK jemi ne dijeni per oferten tuaj me çmimin me te lirë dhe me produkte kualitative Fresenius Medical Care Gjermani, dhe ne kete aspekt nuk kemi ndonje dileme, por administrativisht keni gabuar ne oferten e juaj, me rastin e ofertes tuaj per art. 4 prej 0.00.

Rregullorja e prokurimit Nr. 001-2022 shume qarte e specifikon oferten 0.00 euro per **artikull/pozicion të veçantë** e jo per Lot siç ju pretendoni.

Sa i përket pretendimit ankimor për qasjen ne dokumentacion, kërkesën tuaj për qasje në dokumente të klasifikuara si sekret afarist, Neni 11 i LPP-së qartëson se Autoriteti Kontraktues ka detyrimin të respektojë kërkesat për sekret afarist të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për sa kohë këto kërkesa plotësojnë kushtet e përshkruara në ligj. Sipas Nenin 68 dhe 69 të LPP-së, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të kërkojnë që informacionet komerciale të mbrohen si sekrete afariste nëse ato përmbushin kriteret ligjore.

Është e rëndësishme të theksohet se **Aneksi 3 - Kërkesa për Sekret Afarist** ka qenë pjesë e ofertës se dorëzuar dhe është respektuar nga Autoriteti Kontraktues. Ky aneks është dorëzuar nga të gjithë operatorët ekonomikë, **përfshirë edhe ju si operator ankues.**

Prandaj, qasja në dokumentet e klasifikuara si sekrete afariste është refuzuar në mënyrë të ligjshme dhe të barabartë për të gjithë operatorët, duke respektuar kërkesat për konfidencialitet sipas ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme.

Ne si AK jemi te interesuar për realizimin e projekteve ne te mire te qytetareve, siç eshte edhe ky projekt i parapare te realizohet këtë vit dhe me buxhetin e ndare për këtë vit 2024 dhe çdo vonese ne procedura e rrezikon projektin dhe interesin e qytetareve.


Sa i perket pretendimit se si pale me interes OE Medicom ka te drejte te njoftohet se me çfare pajisje dhe me çfare prodhues ka ofertuar OE i rekomanduar, per kete pretendim shih me poshte tabelen e prodhuesve per Lot 3 te OE te rekomanduar, ku shihet se produktet e perzgjedura nga AK-MSh jane te vendeve evropiane (Dialife - Zvicer, Digiterm - Hungari, Herco – Gjermani).

Furnizimet me Pajisje Mjekësore dhe Inventarët Medicinal për Poliklinikën në Podujevë									
Nr. Art	PËRSHKRIMI I PAJISJEVE	Njësia	Sasia/Copë	Çmimi njësi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)	Prodhuesi dhe vendi i origjines	
1	Aparate për Dializë - HD me të gjitha kyqjet që nevojiten për tu funksionalizuar hapësira për përdorimin e pajisjeve.	Copë	16	9,907.41	792.59	10,700.00	171,200.00	Dialife - Switzerland	
2	Shtretër të HD me tavolinë (set) komplet.	Copë	15	4,814.81	385.19	5,200.00	78,000.00	Digiterm - Hungary	
3	Furnizim me Osmozë Reverte - komplet, kërkohet t'i përmbushë kriteret e prodhimit të ujit të pastër, absolutisht të dejonizuar për dializë. Kapaciteti i Revertës Osmozës duhet të jetë minimum për 15 aparate të Dializës.	Copë	1	69,491.53	12,508.47	82,000.00	82,000.00	Herco - Germany	
4	Të bëhet instalimi i të gjithave elementeve që duhet për vendosjen e aparaturave të Hemodializës në dhomën HCV- Hepatitis C virus dhe dhomën me Hepatit B Virus.	Copë	1	10,169.49	1,830.51	12,000.00	12,000.00	Herco - Germany	
TOTALI i përgjithshëm për Lot 3 (DDP):							€	343,200.00	

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimi